

Numri i lëndës: 2024:036172

Datë: 08.03.2024

Numri i dokumentit: 05428412

**C.nr.788/2024**

**GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA VITI**, gjyqtari Raif Fazliu, me bashkëpunëtoren profesionale Dardana Behluli, në çështjen kontestimore të paditësit I.Q. nga fshati S., Komuna Viti, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson M.H., avokate në Viti, kundër të paditurës Komuna e V.-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi në bazë të inflacionit, vlera e kontestit 562.37 €, jashtë seancës gjyqësore, me datë 08.03.2024, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**I. Aprovohet** pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit paditësit I.Q. nga fshati S., Komuna Viti, **detyrohet** e paditura Komuna e V.-Drejtoria Komunale e Arsimit që paditësit, në emër të pagesës shtesë në bazë të përqindjes së inflacionit, t'ia paguajë: për periudhën janar-dhjetor 2021, shumën 106.03 € dhe për periudhën janar-nëntor 2022, shumën 331.61 €, në shumë të përgjithshme **437.64 €**, me kamatë ligjore 8 % nga dita e ushtrimit të padisë me date 29.01.2024 deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

**II. Refuzohet** pjesërisht pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit në emër të inflacionit, e kërkuar për periudhën janar-dhjetor 2018, në shumën 34.30 €, periudhën janar-dhjetor 2019, në shumën 84.20 € dhe periudhën janar-dhjetor 2020, në shumën 6.23 €, në shumën e përgjithshme 124.73 €.

**III. Detyrohet** e paditura që paditësit t'ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumën 99 €, në afat prej 7 ditëve nga pranimi i aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

### **A r s y e t i m**

E autorizuar e paditësit, me datë 29.01.2024, në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensimi i inflacionit në pagë, vlera e kontestit 562.37 €.

Në padi, paditësja ka theksuar se është në marrëdhënie pune tek e paditura, në Sh.F.M.U. "Dëshmorët e V." në Viti dhe nga gjykata ka kërkuar që e paditura, në emër të pagesës shtesë në bazë të përqindjes së inflacionit, për periudhën janar-dhjetor 2018, t'ia paguajë shumën 34.30 €, periudhën janar-dhjetor 2019, në shumën 84.20 €, periudhën janar-dhjetor 2020, në shumën 6.23 €, për periudhën janar-dhjetor 2021, shumën 106.03 € dhe për periudhën janar-nëntor 2022, shumën 331.61 €, në shumën e përgjithshme 562.37 €. Të drejtën e tij e ka bazuar në nenin 35, paragrafi 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (tutje KKAK) të vitit 14.04.2017 dhe

22.01.2021. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar edhe atë shumën 104 € për përpilimin e padisë dhe 21 € për taksën gjyqësore për padi.

E paditura, përmes përgjigjes në padi, e ka kundërshtuar në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit, me pretendimin se kërkesa nuk është e bazuar në ligj, pasi që obligimet e parapara në KKAK duhet të paguhen nga niveli qendror, Ministrinë përkatëse dhe anën tjetër, ka theksuar se Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Arsimit e kanë shkëputur këtë kontratë andaj rrjedhimisht edhe nuk mund të prodhojë obligim ligjor për të paditurën. Gjithashtu, e paditura është thirrur edhe në parashkrim të kërkesës së paditësit ashtu që, gjykatës i ka propozuar të refuzojë kërkesëpadinë e paditësit të pa bazuar në ligj. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Pas pranimit të përgjigjes në padi, gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës gjyqësore, duke u mbështetur në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (tutje LPK), me të cilin përcaktohet se: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritator, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”, ka ardhur në përfundim se të gjitha kushtet ligjore të përcaktuara në këtë nen janë plotësuar sepse, gjendja faktike nuk është kontestuese e po ashtu nuk ekzistojnë pengesa të tjera që pa caktuar seancë gjyqësore të pranohet si e themeltë kërkesëpadia e paditësit si dhe nenin 399.1 që përcakton se: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritator me të cilin refuzohet si e pa themeltë kërkesëpadia”.

Gjykata ka gjetur se ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese se paditësja është e punësuar tek e paditura, se pagën bazë e ka 259.89 € ndërsa, se shkalla e inflacionit për vitin 2020 është 0.2 %, për vitin 2021 është 3.4 % dhe për vitin 2022 është 11.6 %, fakt i provuar nga llogaritja e shkallës mesatare të inflacionit nga Enti i Statistikave të Kosovës. Duke u mbështetur në nenin 329.1 të LPK-së, gjykata, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror, këtu vet e paditura dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Gjykata, duke pasur parasysh faktin se e paditura nuk i ka mohuar faktet vendimtare e as gjendjen faktike por vetëm bazën e kërkesëpadisë, ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor, pasi themelësia e kërkesëpadisë së paditësit, e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazën ligjore e ka në dispozitat e nenit 55, par. 1 të Ligjit të Punës, i cili ka përcaktuar se: “I punësuar ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin

e Brendshëm të Punëdhënësit”; nenin 90, par. 5 i cili ka përcaktuar se: “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive” dhe KKAK të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, nenin 35, par. 10 sipas të cilit është përcaktuar: “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”.

Sipas Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 40/2023, të datës 27.02.2023 dhe nr. 214/2023, të datës 05.10.2023, dispozitat e KKAK-së për vitin 2017 aplikohen për periudhën 18.04.2017-21.01.2021 dhe për vitin 2021 aplikohen për periudhën 22.01.2021-21.11.2022.

Gjykata refuzoi pjesërisht kërkesëpadinë si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimit pasi që kërkesa për pagesën e shumës së kërkuar për periudhën janar-dhjetor 2018, periudhën janar-dhjetor 2019 dhe periudhën janar-dhjetor 2020, është parashkruar, kjo sepse paditësi ka ushtruar padi me datë 29.01.2024 dhe kështu ka kaluar afatin tre vjeçar brenda së cilës ka pasur të drejtë të realizojë kërkesën e tij edhe atë, duke u mbështetur në nenin 87 të Ligjit të Punës, në të cilin është paraparë se: “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”, nga e cila del se kërkesa e paditësit për kompensim për periudhën e lartcekur, është parashkruar.

Kundërshtimet e të paditurës janë gjetur të pa bazuara sepse palët kontraktuese të KKAK-së, (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), në nenin 2, par. 1.2., kanë përcaktuar: “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit (Komunat-DKA, etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës” andaj, gjykata aprovoi të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Sa i përket pretendimeve se nuk ka pasur inflacion të theksuar, sipas nenit 35, par. 10 të kontratës është përcaktuar se shkalla e inflacionit duhet të përcillet për çdo vit dhe përqindja e saj të futet në pagë dhe anën tjetër, nga Enti i Statistikave të Republikës së Kosovës është përcaktuar se kjo përqindje për vitin 2020 është 0.2 %, për vitin 2021 është 3.4 % dhe për vitin 2022 është 11.6 %.

Vendimi për kamatën është bazuar në nenin 382 të LMD-së ndërsa, për shpenzimet e procedurës në nenin 452.1 lidhur me procedurat e kontesteve me vlerë të vogël, të përcaktuar në nenin 485.1 të LPK-së dhe numrin tarifor 6 nga Tarifa e Avokatëve të Kosovës, ashtu që gjykata ia ka pranuar shpenzimet paditësit në shumën 78 € për përpilimin e padisë dhe 21 € për taksën gjyqësore për padi, në shumë të përgjithshme 99 €.

Nga të lartcekurat, e duke u mbështetur edhe në nenin 142, 398 dhe 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA VITI

C.nr.788/2024, datë 08.03.2024

Gj y q t a r i,  
Raif Fazliu

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimi. Ankesa në kopje të mjaftueshme, dorëzohet nëpërmjet kësaj gjykate.